Ftesë për trajnim

PROCEDURA ADMINISTRATIVE, AKTI ADMINISTRATIV DHE KONFLIKTET ADMINISTRATIVE

Trajnimi mbahet në Durrës 13 – 16 nëntor 2026
Trajnimi është interaktiv dhe mbahet nga ekspert i fushës përkatëse.

Trajnimi organizohet me qëllim të forcimit të kapaciteteve profesionale të zyrtarëve publikë dhe juristëve institucionalë në zbatimin korrekt të procedurës administrative, nxjerrjen e akteve administrative të ligjshme dhe parandalimin e konflikteve administrative.

Baza ligjore e trajnimit:

- Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative
- Ligji Nr. 08/L-176 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që përmbajnë Procedura të Veçanta Administrative dhe Harmonizimin e tyre me LPPA-në
- Ligji Nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative

Në trajnim ndër të tjera do të jenë edhe këto tema:

- parimet themelore të procedurës administrative sipas LPPA-së,
- inicimi i procedurës administrative dhe roli i organit administrativ,
- administrimi dhe vlerësimi i provave në procedurë administrative,
- afatet procedurale, shtyrja e tyre dhe pasojat juridike,
- heshtja administrative dhe akti administrativ i miratuar në heshtje,
- akti administrativ: elementet, arsyetimi dhe ligjshmëria e tij,
- gabimet procedurale dhe materiale në aktin administrativ,
- mjetet juridike administrative dhe trajtimi i tyre,
- harmonizimi i procedurave të veçanta administrative me LPPA-në,
- konfliktet administrative dhe kontrolli gjyqësor i veprimtarisë administrative,
- përgjegjësia e organit administrativ dhe e zyrtarit publik.

Çmimi i pjesëmarrjes: 599 €

Në çmim përfshihen: trajnimi, materiali i trajnimit, certifikata, transporti dhe akomodimi në hotel.
Rezervimi i pjesëmarrjes duhet të bëhet më së largu deri më 12 nëntor 2026.
Numri i pjesëmarrësve është i kufizuar.
Për informata dhe rezervim: **Tel:** 044 / 100 260 ose **Email:** prudencia.consulting@gmail.com